

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- koleji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit R.O, B.B, A.K dhe A.Sh, për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147 par.9 të KPRK-së, duke vendosur për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit R.O, kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.610/2015 të datës 21.11.2017 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.91/2018 të datës 10.04.2018, në seancën e kolegjit, të mbajtur më 06 nëntor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit R.O, e paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.610/2015 të datës 21.11.2017 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.91/2018 të datës 10.04.2018.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr. 610/2015 të datës 21.11.2017, të dënuarit R.O, B.B dhe A.K, janë shpallur fajtor për veprën penale në bashkëkryerje vrasja rëndë nga neni 147 par.4 dhe 9 të KPRK-së dhe të dënuarit janë gjykuar: R.O me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) vite, B.B me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vite, kurse A.K me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vite, në të cilin dënim u është llogaritur koha e kaluar

në paraburgim, kurse me aktvendim të veçantë u është vazhduar masa e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Janë obliguar që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 200 €. Përfaqësuesit e të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Me të njëjtin aktgjykim R.O, B.B, A.Sh dhe A.K, në mungesë të provave janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par.4 dhe 9 të KPRK-së.

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.91/2018 të datës 10.04.2018, ka aprovuar pjesërisht ankesën e mbrojtësve të të dënuarve dhe sipas detyrës zyrtare, ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me kualifikimin juridik të veprës penale dhe ka gjetur se në veprimet e të dënuarve R.O, B.B dhe A.K, qëndrojnë elementet e veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par. 9 të KPRK-së. Ankesat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe e mbrojtësve të të dënuarve R.O, B.B dhe A.K, janë refuzuar si të pabazuara.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit R.O, av. M.H. nga Prishtina, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që i dënuari R.O të lirohet nga akuza pasi që nuk është provuar se ka kryer veprën penale në fjalë ose aktgjykimet e kundërshtuar të anulohen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.172/2018 e datës 23.11.2017, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, përkitazi me shkeljen e ligjit penal, pretendohet se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, kanë bërë shkelje të dispozitës së nenit 385 par.1 të KPPK-së, sepse në veprimet e të dënuarit nuk janë manifestuar elementet qenësore të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par.9 të KPK-së, siç kanë konkluduar këto gjykata. Nga provat në të cilat janë mbështetur aktgjykimet, nuk mund të përfundohet se është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i dënuari R.O në bashkëkryerje dhe me dashje ka kryer veprën për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar. Me anë të këtij aktgjykimi është shkelur në mënyrën më të rëndë parimi i prezumit të pafajësisë i cili imponon prokurorisë barrën e dëshimit të akuzës dhe garanton se nuk mund të prezumohet fajësia deri sa akuza nuk dëshmohet përtej dyshimit të arsyeshëm. Në qofte se gjykata i konsideron të vërtetuara veprimet e të dënuarit, atëherë këto veprime nuk mund të cilësohen si formë e bashkëkryerjes por në rastin më të pavolitshëm mund të cilësohen si ndihmë në kuptim të dispozitës së nenit 33 të KPK-së.

Përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, pretendohet se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, kanë shkelur dispozitën e nenit 384 par.1 nënpar.1.8 dhe 1.12 të KPPK-së, pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë mbështetet në prova të papranueshme dhe nuk është përpiluar në harmoni me dispozitën e nenit 370 par.6 të KPPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka përdorë si prova të drejtpërdrejta procesverbalet e marrjes në pyetje të dëshmitarëve gjatë procedurës paraprake dhe ka bërë krahasimin e tyre me dëshmitë gjatë shqyrtimit gjyqësor duke u besuar deklarimeve të dhëna gjatë procedurës paraprake. Në këtë mënyrë ka shkelur frymën e dispozitës e cila përcakton se gjykata e bazon aktgjykimin e saj vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Për më tepër deklarimi i të dënuarit A.K është përdorë për të vërtetuar fajësinë e të dënuarit R.O e që mbi këtë bazë aktgjykimet janë të kundërligjshme duke pasur për bazë faktin se deklaratimet e mëparshme të dhëna gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor janë devijuar, ashtu që falja e besimit e deklaratimit të dhënë gjatë procedurës paraprake është e papranueshme.

Arsyetimi i aktgjykimet të gjykatës së shkallës së parë është në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimet siç është përshkruar e në veçanti roli i të dënuarit R.O si bashkëkryerës i kësaj vepre penale përkitazi me detyrimet e tij për tu përkujdesur për ardhjen e familjes R. në Kosovë e pastaj për këtë ti tregoj ekzekutuesit kryesor A.M., ashtu që roli i tij nuk mund të jetë i bashkëkryerësit të veprës penale. Po ashtu edhe përkitazi me rolin e tij

ditën kritike se kinse ka bllokuar veturën e tani të ndjerit M.R. me automjetin e tij “Golf” duke i dal në pritë dhe duke ia bllokuar rrugën nuk është vërtetuar as nga ana e dëshmitarëve të dëgjuar. Për më tepër i dënuari R.O nuk ka mundur të identifikohet saktësisht se ka qenë në mesin e personave që kanë qenë në vendin e ngjarjes ditën kur ka ndodhur vrasja.

Më tutje pretendohet për shkeljet të cilat nuk i ka evituar gjykata e shkallës së dytë dhe për më tepër nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të potencuara kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Posaçërisht nuk është dhënë përgjigje përkitazi me procedurën e identifikimit mes të A.Sh (i cili është liruar nga akuza) dhe të dënuarit R.O pasi që ka pasur mjaft paqartësi në saktësinë e identifikimit të këtyre dy personave, ashtu që me këtë rast edhe gjykata e shkallës së dytë ka qenë dashur të veproj sipas parimit in dubio pro reo dhe të vendos në favor të të dënuarit pasi që nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ka marrë pjesë në ngjarjes e zhvilluar. Gjykata e shkallës së parë e as e shkallës së dytë nuk kanë dhënë arsyetim përkitazi me refuzimin e propozimit për dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga mbrojtja L. dhe I.R. pos faktit se kanë theksuar se propozimet janë bërë vetëm për të zvarritur procedurën penale. Po ashtu asnjëra nga gjykatat e instancave më të ulëta nuk ka dhënë arsye përkitazi me mbrojtjen e të dënuarit edhe pse qëndrojnë faktet se ka dhënë mbrojtje kontradiktore, megjithatë asnjëherë nuk ka pranuar faktin se ka qenë pjesëmarrës në vrasje.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit R.O, janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat pretendohet.

Gjykata e shkallës së parë, ka arritur që përmes provave të administruara në mënyrë bindëse të vërtetoj se i dënuari R.O ka vepruar në bashkëkryerje me të dënuarit e tjerë B.B,

A.K, Xh.M. (i cili gjatë zhvillimit të procedurës ka vdekur) si dhe me A.M. (i cili gjendet në arrati), ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe me këtë rast, drejtë ka zbatuar ligjin penal, kur ka konstatuar se në veprimet e të dënuarit janë manifestuar elementet qenësore të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par. 9 të KPK-së. Sipas aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, me të drejtë është konstatuar se kësaj vrasje i ka paraprirë një marrëveshje paraprake mes të pjesëmarrësve të saj dhe atë fillimisht informimi rreth kohës së ardhjes së tani të ndjerit M.R. nga Gjermania në Kosovë. Në këtë kontekst ndërlihet veprimi konkret i të dënuarit R.O, kurse veprimet e tij ndërlihen edhe me zhvillimin e ngjarjes ditën kritike përkatësisht pengimi i lëvizjes së automjetit të të ndjerit me automjetin e të dënuarit R.O i cili edhe ishte duke e drejtuar veturën e tij dhe me qëllim që tu mundësohet Xh. dhe A.M. që të kryejnë vrasjen e tani të ndjerit. Gjykata e shkallës së parë po ashtu drejt ka konstatuar faktin se veprimet e të dënuarit R.O përbëjnë veprime të bashkëkryerjes dhe se këto veprime janë të rëndësishme në drejtim të kryerjes së veprës penale dhe atë edhe në aspektin subjektiv e po ashtu edhe në aspektin objektiv. Në këtë rast padyshim se edhe veprimi i të dënuarit paraqet kontribut substancial, siç konstaton në arsyetimin e aktgjykimit gjykata e shkallës së parë duke cekur se “...veprimet e të akuzuarve kanë qenë të lidhura mes vete dhe të drejtuara me qëllim të arritjes së rezultatit të njëjtë, pra realizimin e vrasjes së M.R. dhe kanë vepruar së bashku duke kontribuar thelbësisht secili në mënyrën e vet dhe secili për të kryer detyrën e vet dhe të gjithë janë gjetur në vendin e ngjarjes...”, kurse përkitazi me të dënuarin R.O janë vërtetuar gjithashtu veprimet paraprake të tij “...se ka patur obligim të informohet për ardhjen e R. prej Gjermanisë në Kosovë, të njoftoj shokun e tij A.M., ditën kritike të vëzhgoj situatën rreth lëvizjes së M...” (përshkrimi i arsyetimit të aktgjykimit të shkallës së parë faqe 39). I dënuari R.O vazhdimisht është interesuar për kohën e ardhjes në Kosovë të M. dhe babait të tij duke i pyetur familjarët e tani të ndjerit e veçanërisht axhën e tij M1.R1. përkitazi me ardhjen e M. pasi që kinse ishte i interesuar për blerjen e banesës së tij e po ashtu për këtë kishte kontaktuar edhe tezën e M. dhe dëshmitarin A.O. i cili kishte lidhje miqësore me familjen R. e për të cilat veprime të të dënuarit gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsye të mjaftueshme në faqen 23,24 dhe 26 të aktgjykimit. Për më tepër, kjo vërtetohet edhe me faktin se dëshmitarët F.R. dhe M.R. kishin identifikuar të dënuarin R.O se ishte personi i cili i kishte kontaktuar ata dhe ishte interesuar për ardhjen e M. në Kosovë.

Po ashtu edhe përkitazi me dashjen e të dënuarit padyshim se është vërtetuar përmes arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë se i dënuari R.O me dashje të drejtpërdrejtë ka

vepruar në rastin konkret pasi që ishte në dijëni përkitazi me raportet mes të dy familjeve R. dhe M. dhe se dashja e tij është përmbushur tërësisht me faktin se *“...vrasja ishte shkaktuar për arsye të motiveve të ulëta meqë vrasja ishte shkaktuar mu për arsye të prishjes së martesës në mes të tani të ndjerit M.R. me ish gruan e tij R.M. që ishte vajza e Xh. dhe motra e A.M., ndërsa të akuzuarit e kishin shok të mirë A.M., andaj edhe kishin pranuar të bashkëpunojnë në drejtim të realizimit të qëllimit të vrasjes së M. për hakmarrje të cilin qëllim e kishin pranuar si të përbashkët (përshkrimi i arsytimit të aktgjykimit të shkallës së parë faqe 39). Në rastin konkret sipas Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë dhe se arsytimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me bashkëkryerjen dhe dashjen e të dënuarit R.O i mbështetë në tërësi edhe kjo gjykatë, pasi që mjaftueshëm janë përshkruar dhe elaboruar të gjitha veprimet e tij sipas dispozitivit të aktgjykimit.*

Nuk qëndrojnë pretendimet në kërkesë se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e saj e bazon në prova të papranueshme edhe pse një pjesë e veprimeve të të dënuarit R.O mbështetë në mbrojtjen e të dënuarit tjetër A.K i cili gjatë procedurës paraprake qartazi ka pohuar prezencën e tij në vendin e ngjarjes. Përkitazi me këtë, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme pasi që i dënuari A.K nuk i ka kontestuar fare deklaratimet e tij të mëparshme por vetëm se gjatë shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur në heshtje që është e drejtë e tij e garantuar më dispozitat e KPPK-së. Për më tepër në rastin konkret veprimet e të dënuarit R.O janë vërtetuar përmes provave tjera e po ashtu edhe përmes mbrojtjes së tij jo konsistente varësisht prej cilës fazë të procedurës penale e ka paraqitur. I dënuari ka mohuar pjesëmarrjen në kryerjen e kësaj vepre penale, mirëpo gjykata e shkallës së parë me kujdes të veçantë ka analizuar mbrojtjen e tij gjatë gjitha fazave të procedurës penale dhe ka gjetur se ka ndryshim të deklaratimeve të tij e sidomos përkitazi me kontaktet me ekzekutorin e kësaj vepre penale Xh.M. duke konstatuar se *“... Xh. e ka kojshi dhe një ditë para ngjarjes i kishte thënë atij me pyet A.O. i cili e ka grua vajzën e vëllaut të M.R. se a ka ardhë M. prej Gjermanisë në Kosovë...”* dhe për ndikimin e familjarëve të Xh. në deklaratimet e tij *“... nuk guxon ta përmendësh emrin e A., thuaj çka të duash por mos e përmend emrin e tij...”* e po ashtu përkitazi me përfshirjen e veturës së tij *“G..”,* ku babai i të dënuarit tjetër B.B i thotë *“...nuk guxon me jav qu policisë kerrin G.. se të vjerri në tela të rrymës e nuk guxon as me përmend B...”*, (përshkrimi i arsytimit të aktgjykimit të shkallës së parë faqe 14). Gjykata e shkallës së parë sipas këndvështrimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për shkak të kontradiktave të theksuara mes mbrojtjes së të dënuarve, me të drejtë ka vlerësuar mbrojtjen e

tyre në të gjitha fazat e procedurës penale dhe kjo është e nevojshme që të bëhet në një proces gjyqësor ku të dënuarit ndryshojnë deklaratimet e tyre dhe se pastaj i mbetet në diskrecion të gjykatës se cilave deklaratime tu besoj. Padyshim se e rëndësishme është të theksohet se të gjitha këto deklaratime janë dhënë në prezencë të mbrojtësve të tyre, kurse ndryshimi i mbrojtësve gjatë fazave të mëvonshme të procedurës penale siç ka ndodhur edhe me të dënuarin R.O i cili mbrojtësin e tanishëm e ka angazhuar pas procedurës ankimore, se nuk e cenon procesin gjyqësor dhe konsiderohet i rregullt pasi që është përmbushur kushti themelor i prezencës së mbrojtësit të tij.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar mjaftueshëm secilën pikë të aktgjykimit të saj ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 370 par.6 të KPPK-së. Andaj nuk qëndron pretendimi se gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar secilën pikë të aktgjykimit. Arsyetim i hollësishëm është dhënë edhe përkitazi me veprimet e të dënuarit R.O dhe veprimet e tij janë cilësuar si dy veprime të ndara, së pari për verifikimin e ardhjes së tani të ndjerit M.R. në Kosovë dhe po ashtu edhe rolin e tij ditën kritike përkatësisht veprimin që duke drejtuar automjetin e tij dhe njëkohësisht duke i zënë rrugën dhe duke e detyruar të ndjerin që ta ndal automjetin në rrugë, i cili veprim është substancial dhe se këtë e kanë pohuar edhe dëshmitarët prezent se vetura e tipit “G...” e të dënuarit R.O është ndalur para veturës ... të cilën në momentin kritik ishte duke e drejtuar tani i ndjeri. Andaj nuk qëndron pretendimi i paraqitur në kërkesë se askush nuk e ka pohuar këtë veprim të të dënuarit, përkundrazi, siç ka konkluduar gjykata e shkallës së parë në faqen 19 të aktgjykimit të saj, duke u bazuar në dëshminë e dëshmitarit M.R., konfirmohet se papritmas është ndalë një veturë e pastaj kanë dalë dy persona që i ka njohur, përkatësisht Xh. dhe A.M., të cilët pas thyerjes së xhamit të veturës kanë shtënë me armë në tani të ndjerin Mensur e cila dëshmi konfirmohet edhe përmes mbrojtjes së të dënuarit tjetër A.K i cili e pohon se automjeti “Golf 4” ishte ndalë para automjetit ... dhe, për më tepër, këtë pozicion të automjeteve edhe e skicon përmes vizatimit të tij.

Edhe gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e saj ka aprovuar të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë dhe me të dejtë ka konstatuar se në rastin konkret është vërtetuar se veprimet e të dënuarit R.O, përbëjnë formën e bashkëkryerjes dhe atë duke u bazuar në provat e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që arsyetimet e theksuara në aktgjykimin e kësaj gjykate në tërësi i mbështetë edhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Nuk ishte i bazuar as pretendimi i theksuar në kërkesë, se gjykata e shkallës së parë dhe po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë dhënë arsyetim të qëndrueshëm përkitazi me refuzimin e propozimit për dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga ana e mbrojtjes L. dhe I.R., por vetëm është theksuar se dëgjimi i tyre vetëm do të zvarriste procedurën penale. Gjykata e shkallës së parë sipas shkresave të lëndës nuk ka refuzuar propozimin për dëgjimin e këtyre dëshmitarëve. Për më tepër, të njëjtit janë ftuar me thirrje të rregullta, mirëpo është theksuar se nuk kanë mundur të sigurohet prezenca e tyre meqë sipas verifikimit përmes autoriteteve policore është konstatuar se të njëjtit gjenden në Gjermani.

Përkitazi me vlerësimin e dëshmive të dëshmitarëve M.R. dhe Sh.R., posaçërisht për identifikimin e të dënuarit R.O dhe A.Sh (i liruar nga akuza) përkatësisht gabimeve të tyre në identifikim, edhe përkitazi me këtë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të hollësishëm. Është e qartë se dëshmitarët okular të vendit të ngjarjes kishin përjetuar një skenë të tmerrshme të vrasjes së djalit të tyre dhe se në këtë kontest edhe jeta e tyre ishte në rrezik dhe po ashtu është e qartë se përveç Xh.M. dhe djalit të tij A.M. me të cilët paraprakisht kishin pasur lidhje miqësore e të cilët qartazi i identifikuan menjëherë, mirëpo patën vështirësi në identifikimin e edhe të R.O. Mirëpo të dënuarin R.O e identifikoj pa asnjë mëdyshje i dënuari tjetër A.K e gjithashtu edhe dëshmitarët M.R. dhe F.R., pasi që e kishin parë më parë dhe kishin biseduar me të dhe e identifikuan përmes faktit se i njëjti gjatë bisedës me ta kishte belbëzuar që e rrit besueshmërinë e tyre se identifikimi ishte bërë në mënyrë të saktë.

Andaj, arsyetimet e aktgjykimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë, i pranon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës, përkitazi me vlerësimin e tërësishëm të mbrojtjes së të dënuarit, dëshmive të dëshmitarëve dhe provave materiale, konstatoj se është dhënë arsyetim i ligjshëm dhe i drejt e që këto konstatime të theksuara kanë përcjellë të gjitha fazat e procedurës penale dhe të dënuarit i është siguruar një proces i drejtë, i rregullt dhe i paanshëm, bazuar në dispozitat e KPPK-së dhe standardet e përcaktuara me KEDLNj.

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, megjithatë bazuar në përmbajtjen e kërkesës, janë paraqitur pretendime për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo, këto pretendime nuk janë vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e

ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj se aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkeljen e ligjit penal dhe shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.248/2018, më datë 06 nëntor 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka